



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI KONKURRENCËS

Nr. 343/prot.

Tiranë, më 14.06.2024

VENDIM

Nr. 1086, Datë 14.06. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE LG – LHT AIRCRAFT SOLUTIONS GMBH, LG – LHT PASSENGER SOLUTIONS GMBH DHE AERQ GMBH NGA SHOQËRIA LUFTHANSA TECHNIC AG.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola Delija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 06. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive LG – LHT Aircraft Solutions GmbH, LG – LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technik AG.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive LG – LHT Aircraft Solutions GmbH, LG – LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technik AG.



Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive LG – LHT Aircraft Solutions GmbH, LG – LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technik AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA () Zv/Kryetar	Rezana KONOMI () Anëtar	Durim KRAJA () Anëtar	Fatjola DELIJA () Anëtar
---	---	--	--

Denar BIBA
()
Kryetar

